



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

00 Numër:41/2024
Data:21.03.2024



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG
Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 25-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet më: **29.03.2024, e Premte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00**.

R E N D D I T E:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Statutit për QKMF në Komunën e Istogut,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2026).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2023.
5. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.31/2024 i datës 29.02.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme private në pronësi të Ismet (Avdyl) Halimaj me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut.
6. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.32/2024 i datës 29.02.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme private në pronësi të Arsim (Ramush) Avdiaj me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut.
7. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.33/2024 i datës 29.02.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme private në pronësi të Herolinda (Avdulla) Osmanaj me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut.
8. Plotësim - Ndryshimi i Vendimit për themelimin e komitetit për Barazi Gjinore.

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e njëzet e katër e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.02.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 10. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj AAK;</u> | 27. <u>Melis Smakic;</u> |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur. Ali Nimanaj dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Nënkyrtari i komunës për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të DEMOS-it, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=PcUFpPDj8lQ>

: "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëzet e katër të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 27 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Statutit për QKMF në Komunën e Istogut,
4. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2026),
5. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.195/2023 i datës 30.11.2023 për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut,
6. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.209/2023 i datës 28.12.2023 për plotësim dhe ndryshimin e vendimit 00Nr.13/2020 për dhënien në shfrytëzim me negociim të pronës së paluajtshme të komunës me "Ulpiana Balaj" SH.P.K,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të Ismet Halimaj,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të Arsim Avdijaj,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të Herolinda Osmanaj,
10. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- e kemi njoftimin me rekomandimin që e ka dërguar Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kërkesë të këshilltarit Negjdet Ramaj, që e ka dhënë dy mbledhje më parë, por është vonuar, pra e kemi adresuar në MAPL e cila ju është drejtuar Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, kështu që e propozoj si pikë të rendit të ditës, sepse atë ditë kur e ka propozuar këshilltari Negjdet Ramaj, është votuar Rregullorja komunale por që ka mbetur të inkorporohet në bazë të rekomandimit ligjor për këtë çështje. E kanë kthyer ashtu siç duhet dhe kjo duhet të votohet që të inkorporohet në Rregullore për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha. A ka dikush tjetër ndonjë propozim për pika të rendit të ditës? Drejtori Abedin Kabashi e ka fjalën.

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ne muajin e kaluar me 31.01.2024 e kemi miratuar ngritjen e tarifës për kompaninë "Ambienti" dhe na ka ardhur një vendim prej

MAPL-së që të bëhet rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit. Arsyeimi i ministrisë është ky: Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të vendimit Nr.06/2024 KRM “Ambienti” njësia operative në Istog ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave konstaton se: vendimi i cekur më lartë duhet të përfshijë edhe Ligjin Nr. 08 L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr 04 L-060 për mbeturina. Që d.m.th i njëjti vendim për ngritje ka shkuar edhe vitin e kaluar por kësaj radhe kanë kërkuar që të bëhet edhe një korrigjim i vogël që në vendimin që e kemi marrë si Kuvend ti përfshimë edhe këto dy ligje. Andaj kërkoj nga ju, që ta futim në rend dite edhe njëherë Shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së KRM “Ambienti” njësia operative Istog për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit transportimit dhe deponimit të mbeturinave. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush nga ekzekutivi apo prej këshilltarëve ndonjë propozim për rend dite, apo ka ndonjë vërejtje a sugjerim rreth pikave të rendit të ditës?

Atëherë i hedh në votim këto dy pika të propozuara, kush është që të futen në rend dite propozimi i Negjdet Ramaj?

Konstatojmë që nga 27 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 27 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim votohet që të futet kjo pikë në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Lidhur me këtë propozim që e kemi pasur që të lirohen nga taksat që janë të përcaktuara me ligj për Veteranët që të përfshihen edhe familjet e veteranëve dhe dëshmorëve, është mirë që të titullohet plotësim ndyshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha dhe e shtojmë një bazë të re ligjore që harmonizohet me ligjin për lirim nga taksat për veteranët dhe familjet e dëshmorëve. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- tani e hedh në votim propozimin e drejtorit Abedin Kabashi. Kush është që të futet në rendin e ditës për mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 27 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 6 abstenim votohet që të futet kjo pikë në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Konstatojmë që në mbledhje janë 27 anëtarë të Kuvendit të pranishëm.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë rreth procesverbalit nuk kam ndonjë vërejtje por rreth rrjedhjes së mbledhjes, edhe në procesverbal që është shkruar kam vërejtje. Pikërisht lidhet me pikën e nëntë të rendit të ditës të Rregullorja për Arsim, faktikisht propozimin që e kam bërë për zëvendësimin e orëve nga ana e profesorëve profesionalistë të lëndës përkatëse nuk ka ardhur në konsideratë të hyj si nen në atë rregullore. Ndërsa ajo pika që u tha nuk dua të merrem me emra, rreth asaj që duhet të bartin uniformën të gjithë e që është nënkuptuar në rregulloren e vitit 2018 ajo ka hy në propozim. Pyetja ime është pse

propozimi që është bërë nga unë nuk u hedh në votim, ndërsa i kolegut tjetër po? Këtë mund ta drejtoj ty kryesues pikërisht, e sa i përket kësaj kërkoj sqarim edhe nga drejtori i arsimit. Unë kam pasur edhe propozime tjera, por meqë keni thënë që bien, futja e këtij neni kishte me e pasuruar atë rregullore dhe kishte me e zgjedhur një çështje, sepse kjo rregullore e dimë që është afatgjatë deri në vitin 2027 nëse nuk gabohet, dhe mos të futet ai nen që ka qenë në të mirë të arsimit, sepse nëse ora ime zëvendësohet nga një profesor tjetër plan programi im do të mbetet i pa realizuar, kam një hatërmjetje jashtëzakonisht të madhe sepse neni im nuk ka hyrë dhe për këtë unë kërkoj përgjigje, kaq kam rreth kësaj nuk e di pse propozimet e mia nuk kanë hasur në mirëkuptim që të hedhen në votim, nuk ka qenë e thënë që të miratohet, por së paku të bëhet e mundshme të afrohet sepse është në të mirë të nxënësve, të qytetarëve dhe arsimit në përgjithësi në komunën tonë. Jam e vetëdijshme që Rregullorja tani është votuar, por është votuar pa propozimin tim që nuk është në rregull aspak dhe nuk është respektuar as autoriteti im këtu.

Kryesuesi i Kuvendit- ju kam thënë që duhet ta bëni tekstin, duhet ta propozoni që ta futim në votim, unë i dhashë afat Hajrushit ta bëj tekstin, e ka bërë e kam hedh në votim, sepse nuk bën vetëm që ke diskutuar të hidhet në votim, unë nuk kam drejtë të ja ndaloj askujt amadamentimin.

Ajshe Metaj- ashtu siç i ke dhënë kohë kolegut Hajrush është dashur edhe mua, mua nuk më është dhënë as afati të them asgjë më. Nuk kam pasur asnjë interes personal, por vetëm të dalë sa më mirë Rregullorja. Nuk kam pas zgjidhje pos të reagoj, je kryesues i të gjithëve këtu, nuk kam se çfarë të shtoj më, por kjo që ka ndodhë ka qenë shumë keq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i Arsimit.

Naim Behlulaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Arsyetimi pse nuk ka dalë në votim ka qenë sepse Ministria e Arsimit e ka një udhëzim administrativ i cili i përcakton qartë objektivat e zëvendësimit të orëve. Drejtori i shkollës e thotë në udhëzimin e ministrisë që është i obliguar ta gjej formën për zëvendësimin e orëve edhe kjo ka qenë arsyeja që nuk ka dalur në votim profesoreshë. Ndërsa te propozimi i Hajrushit që e la dhënë për uniforma, unë me pikën 37 ka qenë të gjithë punonjësit, mirëpo e keni propozuar e keni votuar, nuk e imja, e imja është të jap sqarim se nuk guxoj ta shkel Udhëzimin Administrativ të Ministrisë që përcakton që drejtori i shkollës e ka për obligim ta gjej formën për zëvendësimin e orëve.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- me gjithë respektin që e kam për ju drejtor, aty nuk ishte bërë asnjë shkelje as nga ministria as nga askush, ku prej atij neni kërkohet të plotësohet diçka që e pasuron atë Rregullore, nuk ka pasur të drejtë askush të thotë që shkelet Rregullorja dhe kthehet, kjo që unë kam dashur me keqardhje por nuk ka qenë shkelje e Rregullores, specifikimi i zëvendësimit të orëve pikërisht është dashur të ketë të drejtë ta zëvendësoj vetëm profesori i kimisë, arsyeja shkaku e tregova edhe njëherë se te unë edukata fizike vetëm i angazhon ata fëmijë dhe plan programi im mbetet i pa realizuar, kjo nuk të jep as shkelje as asgjë, keni bërë keq që nuk ma keni marrë parsysh e me e fut në propozim, kam anashkalim në shumë aspekte, jam e drejtpërdrejtë edhe flas, me vjen keq drejtor nuk ke pasur të drejtë mos ta futesh propozimin tim, kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Naim Behlulaj- profesoreshtë unë nuk jam ai që e ka ndalur propozimin e asnjërit këtu, ju i propozoni ju i votoni. Nuk kemi të drejtë të shkelim Udhëzimin e Ministrisë, Ligji është më i madh se Rregullorja. Sa i përket orëve të humbura, sot mundet t'i zëvendësoj.

Ajshe Metaj- më vjen keq por kjo arsyetim nuk ka.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- e shikova edhe në procesverbal, ishte që kam kërkuar që të hidhet një çështje në votim, dhe ju z. kryesues nuk e keni fut, e po thuani që nuk guxoj ta anashkaloj kur një këshilltar kërkon të votoj diçka, atë ditë nuk e ke hedh në votim as propozimin tim as të Ajshes. Dhe ajo Rregullore nuk është bërë vetëm për kiminë, por p.sh te unë mua nuk mundet të më zëvendësoj askush se jam i vetmi në shkollë me gjuhë gjermane por tani ajo ka kaluar, vetëm më nxiti ajo që nuk the nuk guxoj mos ta hedh në votim e shpesh po ndodhë kryesues. Shpresoj që në të ardhmen mos të ndodhë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- kur ta bësh amandamentimin po, thua dua ta hedh në votim, e hedhim në votim, vetëm po diskuton Florin, edhe është rasti me Ajshen, është thënë këtu prej drejtorit që e atakon ligjin, dhe Ligji është më i madh se Rregullorja, dhe pse me e dërguar e me u kthyer.

Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- kërkesa ime ishte rreth procesverbalit, është tek faqja e pestë, ku kam kërkuar të hidhet diçka në votim dhe ju nuk e keni bërë.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth procesverbalit? Pasi që jo, atëherë kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota për 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi diskutimin a keni diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës? Andi Xhuraj e ka fjalën.

Andi Xhuraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Edhe pse kjo shkon në diskutim publik unë e kam një propozim që policët e Stacionit Policor në Istog të lirohen nga shërbimet administrative të cilat i paguajnë në QKMF në Istog në vlerë të (dy) 2.00 euro. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- tani vetëm të sqarohemi Andi, sot kjo nuk ka nevojë të votohet, shkon në diskutim publik, drejtori është këtu e konsulton ligjin. Fjalën e ka drejtori Zenel Shatri.

Zenel Shatri- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket lirimit të policëve apo kategorive të ndryshme ato përcaktohen me Rregulloren për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha që është aprovuar më parë. Në këtë statut kryesisht janë të parapara shërbimet që kryhen në QKMF. Ky statut ka qenë edhe më parë por tani janë bërë disa ndryshime në organizimin, p.sh ne jemi si pilot

komunë, bëhet përcaktimi i mjekut familjar për zona të ndyshme. Për këtë statut neve na ka ardhur një statut unik në të gjithë Kosovën. Bëhet fjalë vetëm për organizimin e shërbimeve në kujdesin primar shëndetësorë. Është e bazuar në ligj, nëse keni ndonjë propozim, mund ti shqyrtojmë apo ti votojmë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Andi, kur të votohet ky Statut në Kuvend, atëherë shkon Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, duhet si atë që e ka propozuar Negjdeti, si plotësim ndryshim, atëherë hyn në fuqi. Fjalën e ka Veton Kurti.

Veton Kurti- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë këtë Statut e kam lexuar, vetëm desha ta pyes drejtorin për përdorimin e ultrazërit, e specifikon aty që kanë me u aftësuar, a vlen vetëm për mjekët familjarë apo edhe për mjekët e përgjithshëm.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Zenel Shatri- është e precizuar duhet të jetë specialist i mjekësisë familjare pastaj ta përdorë ultrazërin. Pa qenë specialist jo.

Kryesuesi i Kuvendit-

Ajshe Metaj- e kam lexuar Rregulloren është bukur e mirë, por i kam disa diskutime, psh te neni 6 ku thotë në QKMF ekziston materniteti këtë punë e dimë, por a ekziston gjinekologu në këtë vend, e shoh si arsye që të sqarohet, a ekziston gjinekologu apo jo, dhe neni 7 ku thotë te shërbimet që i kryen QKMF-ja pra për shëndetin riprodhues, kush është përgjegjës dhe a keni kandidat si dhe shërbimet që i kryen për shëndetin mendor, këto shërbime janë të shkruara në nenin 7 por a kryhen realisht, a ekzistojnë profesionalistët që merren me këto lëmi. Poashtu te neni 22 e kam te zhvillimi i vazhdushëm profesional i punëtorëve shëndetësorë, është drejtori i QKMF-së i cili përcakton kush duhet të shkoj të vazhdoj më tutje zhvillimin dhe cilat burime i shfrytëzoni ju a keni buxhet të mjaftueshëm sepse ky është i kushtueshëm të zhvillohet vazhdimi profesional. Si dhe te neni 26 te buxheti, sigurisht drejtori i financave merret me atë se a ndahen proporcionalisht në ato lëmi si duhet apo keni ndonjë mundësi me e përmirësuar që në ndonjë nga sektorët e shëndetësisë të investohet me shumë apo më pak. Rreth buxhetit e kam edhe një pyetje, aty u tha decidivisht te ky nen se drejtori i QKMF-së ju propozon drejtorit komunal të arsimit për me e bërë auditimin e brendshëm kushtimisht dhe pyetja për ju është a keni realizuar ndonjë auditim të brendshëm që të dihet se si po shkon rrjedhja e financave në ministrinë e shëndetësisë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Zenel Shatri.

Zenel Shatri- shërbimi i gjinekologjisë dhe i akushërisë në Istog është i përgjysmuar. Akushëria nuk mundet të mbahet realisht sepse pa pasur sallë operative dhe gjinekolog permanent është e pamundur. Është në letra, dhe mendojmë që kur të hapet QKMF-ja e re është e paraparë edhe akushëria se sa do të realizohet mbetet pikëpyetje. Unë kam bërë çmos si drejtor që të mbetet akushëria sepse aty ku nuk ka akushëri nuk ka pediatër. Gjinekologu ekziston është si konsultant, presim të na kthehen dy, vjen gjinekologu dy-tri herë në javë. Për zhvillimin mendor kemi psikiatrin të rregullt. Kemi psikologun klinik poashtu si konsultant. Për zhvillimin e vazhdushëm të edukimit shëndetësor ekziston për çdo organizatë dhe pranë QKMF-së, ajo organizohet brenda, ekziston koordinatori, është bordi, janë strukturat, kurse edukimi i vazhdushëm për infermierë është funksional më shumë se sa për mjekë sepse këta

poentohen dhe në bazë të poenave ata licencohen, problemi është të financimi. Vjet e kemi bërë auditimin e brendshëm. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor për ekzaminimin. Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kemi lexuar statutin, pasi del në diskutim publik pres nga fokus grupet që të marrin pjesë, edhe ne si grup do e japim fjalën atëherë kur të vjen prapë në Kuvend. Sa i përket propozimit të Andit pajtohem plotësisht por nuk e di sa kemi mundësi dhe sa mundemi ta inkorporojmë në Rregullore. Kshtu që sa i përket kësaj që tha Andi jo vetëm për participim por kisha thënë për të gjitha shërbimet që ju takojnë të mjeksisë familjare të lirohen nga taksat.

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Drejtori Zenel Shatri e ka kërkuar fjalën.

Zenel Shatri- jep disa sqarime shitesë.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që kjo pikë të shkoj në diskutim publik?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim votohet pika e rendit të ditës ' Shpallja në diskutim Publik e Draft - Statutit për QKMF në Komunën e Istogut.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës, është për diskutim publik. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe kjo Draft-Strategji që është e mirëseardhur edhe pse ende mund të plotësohet më tutje, e kam lexuar me vëmendje. Viktimat e dhunës në familje, vendin e fundit kur ikin nga familja e kanë strehimoren. Çështja e strehimores dihet që është në Pejë, kështu që rreth mbështetjes financiare të stehimores, sa arrin komuna jonë që ta mbështes atë strehimore duke marrë parasysh numrin e të strehuarëve apo viktimave të dhunës në familje. Një shkaktar jashtëzakonisht i rëndësishëm që shkakton dhunën në familje është pabarazia gjinore, sa ka mundur komuna të ndërhyej këtu të eliminoj pak a shumë në mënyrë që ta ndyshoj situatën. Rreth pabarazive gjinore sidomos është me rëndësi të theksohet çështja e punësimit, në komunën tonë të punësuar janë nëse nuk jam gabim siç e kam parë këtu 195 të punësuar në përgjithësi, prej të cilëve vetëm 64 janë femra, pra këtu është një pabarazi e shpërfaqur. Në vitin 2021 janë strehuar gjithsejt trembëdhjetë viktimat të dhunës prej tyre tetë gra dhe pesë fëmijë pastaj janë përcaktuar edhe nacionalitetet, ku ka dominuar ai shqiptar, në vitin 2022 janë pesë viktimat, prej tyre tri gra dhe dy fëmijë dhe në vitin 2023 numri i viktimave është rritur prej tyre njëmbëdhjetë gra dhe tetë fëmijë, ku prej këtyre njëmbëdhjetë grave gjashtë prej tyre kanë qenë të nacionalitetit shqiptar, dhe të tjerët të nacionaliteteve të tjera. Pra vendi i fundit ku përfundojnë është strehimorja ku e cila sipas parametrave vend qëndrimin e ka vetëm gjashtë muaj, por ka edhe të tillë që nuk zgjidhen problemet e tyre, kjo duhet të zgjatet, por edhe rreth zgjatjes së këtij mandati të qëndrimit të tyre është parë se mund të qëndrojnë deri në një vit, por gjatë qëndrimit të tyre a planifikohet në buxhet mbështetja financiare e strehimores. Faktorë tjetër që kanë është edhe trashëgimia, ku gruaja është e përjashtuar nga çështja e trashëgimisë, a keni ju ndonjë matje që ka ndërruar situata në të mirë. Te fuqizimi i gruas në shoqëri është një

faktor që ka për ta nxjerrë gruan nga situata, dhe ka të bëj me proceset vendimarrëse. Pyetja është në krahasim me vitet e tjera po e shoh se pak është përfaqësuar në pozita vendimarrëse por a kishit mundur të bëni më shumë ta fuqizoni rolin e gruas në procese vendimarrëse, e kam fjalën për caktimin e drejtoreshave femra. Te mbështetja financiare a ka edhe ndonjë fond shtesë përpos buxhetit komunal që duhet të jetë i planifikuar dhe nga vijnë ato mjete. Te strehimi komuna mund të bëj edhe lehtësime tjera duke planifikuar edhe ndonjë vend pune, apo ofrimi i ndonjë subvencioni nëse viktimat mendojnë të hapin ndonjë biznes. Kaq kisha.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit profesoreshë! Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- pëshëndet të gjithë të pranishmit! I kam dy pika te ky draft-strategji dhe plani i veprimit, e kam lexuar, dhe sa i përket pjesës së parë te dhuna në familje nuk është specifikuar buxheti sa ka me u ndarë apo në cilat fusha apo aktivitete ka me u përkrahur, nëse është plan i veprimit për dy vite duhet të specifikohet. Nuk kam parë të specifikuar ndarje të një buxheti apo ofrimeve të shërbimeve emergjente për viktimat e dhunës në familje sepse nganjëherë vijnë papritmas, nëse i kemi ato raste, ofrimi i shërbimeve mjekësore, të shëndetit mendor për viktimat e dhunës në familje, duhet të specifikohet buxheti edhe për këtë pjesë. Është një pikë ku e praktikojnë edhe komunat tjera, ndërmjetësimin në punësim sa i përket rasteve të dhunës në familje, sepse ato femra mbesin pa përkrahje dhe kur dalin nga ajo strehimore kërkojnë punësim sepse ka ndodhur konflikti dhe është çështja sa bën komuna, a ka paraparë në këtë plan të veprimit të ndërmjetësor me ndonjë firmë me ju ofruar punësim këtyre grave. Te pika e dytë te barazia gjinore është potencuar në një vend aty fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozita vendimarrëse. E dimë edhe premtimin e fushatës së kryetarit Ferati dhe nënkryetarit Nimanaj ku drejtoritë kanë me u ndarë 50-50, ku në këtë rast i kemi dymbëdhjetë drejtori dhe prej tyre vetëm dy femra. Pasi po në këtë plan është potencuar që do jetë 50-50, pyetja ime për organet vendimarrëse është si do arrini, nëse vet jeni shembull jo i mirë sa i përket barazisë gjinore në komunë. Faleminderit shumë.

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron edhe dikush fjalën? Pasi që jo ftoj Vlora Gjocin të ju përgjigjet pyetjeve të këshilltarëve.

Vlora Gjoci- përshëndet të gjithë të pranishmit! Po e lidhi si pyetje të përbashkët te pozitat vendimarrëse, ne e kemi diskutuar së bashku me grupin punues kur e kemi futur në plan, duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore, mbetet në dorën e institucioneve sa do të kontribuojnë, mbetet e jona të shohim se sa punohet dhe do të arrihet kjo përqindje. Sa i përket buxhetit varësisht prej aktiviteteve që i kemi në plan, pastaj ne e caktojmë sa na duhen mjete që të realizohet ai aktivitet, ka qenë vendim i përbashkët i grupit punues.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta ngris një shqetësim duke e marrë për bazë që në nivel vendi nga dhjetori i vitit të kaluar e deri në janarin e këtij viti afërsisht janë raportuar 2000 raste që ka pasur dhunë në familje, dhe ajo që është më shqetësuese 90% të këtyre rasteve janë gra dhe vajza. Si qendër për punë sociale pata një pyetje, a ka ndikuar në zbutjen e kësaj mase ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave vendimi i qeverisë që është mbajtur në tetorin e vitit 2022 ku është vendosur që masat ndaj atyre akterëve që bëjnë dhunë në familje të jenë më të rrepta, dënimet më të larta, dhe a ka ndikuar kjo në zvogëlimin e dhunës në komunën tonë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtoresha Merita Bytyçi.

Merita Bytyçi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ato politikat e qeverisë siç po shihet kemi rritje të rasteve të dhunës në familje, por për fat të mirë jemi ndër të paktat komuna që i subvencionojmë këto kategori, pra kanë gjetur përkrahje nga komuna jonë.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- te përkrahja atje u pa, më vjen mirë që dyfishohet. Ju thatë që i mbështesim me pagesë të qirasë, por cilat janë ato mbështetjet tjera?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtoresha.

Merita Bytyçi- i subvencionojmë me pagesë të qirasë, me pako ushqimore dhe në varësi të kërkesave të tyre që kanë.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Kur flasim për dhunën në familje zakonisht flitet për dhunën ndaj grave, unë kam një pyetje pak më specifike, dua të flas pak për dhunën ndaj fëmijëve, çfarë ndodhë me një fëmijë të dhunuar në familje, cilat janë procedurat, ku strehohen ata fëmijë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Vlora Gjoci.

Vlora Gjoci- kur jemi te fëmijët, nëse e lidhim me shtëpinë e sigurt, ose nuk përfundojnë të gjitha viktimat në shtëpinë e sigurt, mund të qëndrojnë në shtëpi ose te të afërmit e tyre momentin që ndodhe dhuna në familje, rasti paraqitet në polici ose në Qendrën për Punë Sociale, të dyja bashkërisht e udhëheqin rastin, nëse p.sh prindërve ju merret zotësia e veprimt apo e prindërimit, atij fëmijë i caktohet një kujdestar ligjor, por nëse vazhdon të qëndroj tek nëna ose babai atëherë te Qendra për Punë Sociale, është figura e punëtorit social, psikologu, bëjnë trajtimin e atij fëmijve që ta tejkaloj sa më lehtë traumën, gjithëherë është Qendra për Punë Sociale që merret me mbështetjen e rasteve të dhunës në familje.

Kryesuesi i Kuvendit- një plotësim drejtoresha pastaj fjalën e ka Niman Beqiraj.

Merita Bytyçi- në Qendrën për Punë Sociale funksionon organi i kujdestarisë dhe në bazë të kësaj si organ i kujdestarisë ka të drejtë në heqjen e prindërimit në rast se ai fëmijë keqtrajtohet, dhe e dërgojmë te një familje strehuese.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam vetëm një sugjerim që gjatë diskutimeve verbale nga drejtorët apo ekzekutivi i komunës të quhen me emrin e saktë 'viktimat e dhunës në familje' e jo me emrin që e dëgjova disa herë 'klientë' ne e dimë që dallimi mes këtyre është i madh se klienti shkon për qejf e viktimat për shkak të dhunës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- e qëlluar, faleminderit Niman! Fjalën e ka Valbonë Demaj.

Valbonë Demaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje ndryshe, çka mundemi ne si shoqëri që ta bëjmë parandalimin që mos të shkojmë deri te dhuna, e jo vetëm ndihmë pasi të bëhet dhuna, kështu që si shoqëri mundemi të bëjmë diçka ta parandalojmë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që nuk ka diskutime, e hedh në votim, kush është që kjo të shkoj në diskutim publik?

Konstatohet që nga 27 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 27 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim votohet pika e rendit të ditës ' Shpallja në diskutim e Draft - Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2026).

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kërkuar Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- desha vetëm ta përgëzoj Vlorën për elaborimin që e bëri, nuk kam dëgjuar elaborim më të mirë as nga drejtorët, dhe shpresoj ta kenë parasysh drejtorët sesi duhet të elaborohet. Faleminderit!

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- me vonesë por e kanë kthyer në rishqyrtim këtë akt MAPL-ja, unë e hapi diskutimin rreth kësaj pike. Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- si këshilltar politik i këtij Kuvendit dhe në emër të Lëvizjes Vetëvendosje unë te kjo pikë dhe pika që vjen pas kësaj e disa tjera e kam një këshillë për ekzekutivin që të kenë kujdes me këto pazare që po i bëjnë me pronat e komunës. Po na i sjellni këtu, po na shtini me i votuar,, pastaj MAPL-ja po na shtin me i ra pishman atë që e kemi votuar, keni kujdes, konsultohuni me ligjin, faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- përshëndet të pranishmit dhe prezanton dhe jep sqarimet e nevojshme rreth pikës së rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- kryesues drejtorët nuk kanë të drejtë me na treguar neve se çfarë të themi. As nuk kanë të drejtë të na kërcënojmë me gjyq, le të shkoj, po e them fjalën publikisht nëse keni diçka le ta dërgojnë në gjykatë, këto nuk janë fjalë që mundet të na thotë drejtori, e di shumë mirë kryesues dhe nuk po reagon.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë besoj që ligji e lejon plotësisht edhe vendimi të cilin e ka sjellë kryetari për miratim dhe është miratuar në këtë Kuvend është plotësisht i ligjshëm. Prandaj kisha kërkuar nga të gjithë kolegët e mi që mos të shfuqizohet ky

vendim dhe të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme. Ligji e thotë qartë, kështu që nuk ishte dashur që ky vendim të anulohet, unë jam që mos të anulohet ky vendim. Qytetari ka të drejtë të bëj kërkesë, e ka bërë kërkesën të ndërrohet prona dhe prapë po e them besoj që është shumë e ligjshme dhe e arsyeshme të ndërrohet ajo pronë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- e kemi bërë si lloj praktike që çdo shfuqizim që vjen prej MAPL-së ta votojmë gjithmonë. Nëse ne mendojmë që këto janë të ligjshme atëherë edhe unë jam me mendimin e kolegut Hajrush mos ta votojmë shfuqizimin e këtyre vendimeve.

Kryesuesi i Kuvendit- edhe dikush a e dëshiron fjalën? Pasi që jo, atëherë po e hedh në votim, kush është që të shfuqizohet ky vendim?

Konstatohet që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 15 vota për 0 kundër dhe 11 abstenime nuk shfuqizohet Vendimi 00.Nr.195/2023 i datës 30.11.2023 për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- e ftoj drejtorin Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- prezanton pikën e rendit të ditës dhe jep sqarimet e nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! E hapi diskutimin, fjalën e ka kërkuar Agron Gashi.

Agron Gashi- e kemi diskutuar mbledhjen e kaluar gjatë edhe kemi qenë kundër, edhe kjo pikë nuk është si pika para kësaj, këtë e kanë kthyer për diçka tjetër. Unë e kam një çështje tjetër e potencoj edhe Florini më herët. Me e llogarit që dy vite në çdo seancë e kemi pasur nga një kthim, d.m.th nuk ju përmbaheni ligjit sepse ligji e specifikon qartë kush mundet e kush jo. Edhe po ta kthen me nen që nuk e ke respektuar, po na humbni kohë, dhe po doni ta shfuqizoni me dalë në kundërshtim me ministrinë. Shihet ligji, neni, më vjen keq nganjëherë që emrat tonë shkojnë atje në çdo vendim që na kthejnë. Në mbledhjen e fundit kemi diskutuar shumë, e kam parë këtë edhe e kam ditur që është në kundërshtim me ligjin, ne nuk jemi kundër bizneseve por kundër shkeljes së ligjit. Kolegu Hajrush dhe Haki duhet të kërkojnë falje për deklaratat që i japin, ne pikërisht prej biznesmenëve kemi marrë ankesa për rastin në fjalë. Duhet me pasur konsistencë, me e parë ligjin edhe me e tërhequr fjalën Hajrush. Kemi përkrah shumë vendime që kanë qenë në pajtim me ligjin, por jo me shkel ligjin për një biznes të caktuar. Kërkesë e cila pa filluar biznesi fare ju doni ta përkrahni për diçka tjetër ku ajo vet nuk po funksionon. Kryesues unë këtu kam vërejtje sepse këto vendime po kthehen dhe duhet me qenë më konkret edhe në kërkesa edhe në fjalime. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- fillimisht ju kisha përgjigjur Agronit. Askush nuk më ka detyruar ta marrë fjalën atë ditë dhe të mbroj ndonjë paligjshmëri. Nëse thotë ligji për këmbim të pronës(i referohet neneve të caktuara) nëse dikush ma argumenton se ky Kuvend e ka cenuar 10% ose me vendimin që është marrë është ndërruar 10% e investimeve, kërkoj shumë falje. Mirëpo unë

besoj shumë që atë ditë Kuvendi e ka marrë një vendim në të mirën e biznesit në të mirën e qytetarëve. Jam kundër shfuqizimit të këtij vendimi, le të merret gjykata, le ta vërtetoj se kush ka pasur të drejtë, pas vendimit të gjykatës nëse nuk kam pasur të drejtë do kërkoj falje, por nuk është në rregull. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- këtu në arsyetim thotë që, veprimtaria për të cilën është dhënë prona në shfrytëzim nuk është në harmoni me atë që e ka kërkuar para dy vitesh. Problemi po qëndron se këta e kanë ndërruar destinacionin. MAPL-ja e ka kthyer për këtë qëllim, pra me e kthyer krejt në fillim. Ne e dimë që një person mundet me e marrë një pronë të caktuar dhe me kërkuar me e bërë një lloj ndërtese, mirëpo atë ndërtesë me e ngrit edhe shtatë-tetë kate, pas dy vitesh me e kërkuar një kërkesë të re për negociim të ri e ne fund me i humb efekti se për çfarë është dhënë në fillim. Ne e përkrahim këtë shfuqizim dhe do votojmë për ta shfuqizuar. Edhe nëse është puna tek përkrahja e bizneseve ashtu siç tha Hajrushin ne jemi të gatshëm me ja ndarë biznesit në fjalë një tokë diku tjetër më të madhe sepse me 25 punëtorë në fakt me një ari e gjysmë nuk e di se ku dhe i dërgojë ata. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- po ta garantoj që nëse nuk do ishte objekti i ndërtuar edhe unë do kisha qenë për shfuqizim, mirëpo çfarë do bësh me objektin, nëse ka fuqi Nimani me e marrë e me dërguar atë objekt diku tjetër po po ja pranoj, janë mbi 500 m objekt, nuk e ka cenuar fare investimin me vendimin që është marrë, ju është lejuar një veprimtari që ndoshta për mua nuk ka pasur as pse të futet në Kuvend, kemi me dhjetra prona që janë të uzurpuara që nuk kemi me pasur mundësi kurrë me i liruar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- objektin ai që e ka ndërtuar besoj që e ka planifikuar për veprimtarinë e parë për të cilën e ka marrë vendimin, nëse ka llogaritur me ndërtuar ndërtesë e paska bërë pa plan, si mund të ndërtosh pa e marrë aprovimin e Kuvendit. Nuk mundesh kurrë me e bërë një arsyetim e ka bërë njeri një objekt e me lënë, nuk ka kuptim.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- unë besoj që ai e ka lejen e ndërtimit nga Kuvendi komunal që është lëshuar. Dhe është duke u punuar konform gjitha rregullave që i parasheh leja, nëse është dalë jashtë lejes kisha kërkuar që të intervenohet, ai vetëm ka kërkuar që të shtohet një veprimtari. Nuk e ndalon askush që të ri negociohet, Nimani me kolegët e vet e ka bërë ankesën në MAPL unë nuk jam për me e shfuqizuar, le të vendos gjykata.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- unë asnjëherë nuk e thashë që objekti nuk ka leje, por e potencova që e ka lejen për çfarë e ka marrë në fillim. E ka negociimin e parë që e ka bërë për biznesin e parë, le ta vazhdoj veprimtarinë, nuk jemi duke ja marrë. Kjo forma e ankesës në MAPL, është adresa jonë e vetme që ne si këshilltarë mundemi me e bërë një ankesë në rastet kur perdoret vrazhdësia e numrave këtu në Kuvend. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që nuk ka më diskutime, po e hedh në votim, kush është që të shfuqizohet ky vendim?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 14 vota për 5 kundër dhe 5 abstenime nuk shfuqizohet Vendimi 00.Nr.209/2023 i datës 28.12.2023 për plotësim dhe ndryshimin e vendimit 00Nr.13/2020 për dhënien në shfrytëzim me negocim të pronës së paluajtshme të komunës me "Ulpiana Balaj" SH.P.K,

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- prezanton pikën e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të znj. Herolinda Osmanaj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! A e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo e hedh në votim, kush është që të miratohet ky vendim?

Konstatohet që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota për 1 kundër dhe 2 abstenime miratohet pika e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të të komunës me pronë private në emër të znj Herolinda Osmanaj.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- prezanton pikën e rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të Ismet Halimaj.

Kryesuesi i Kuvendit- kush dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Pasi që askush, e hedh në votim, kush është që të miratohet ky vendim?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota për 1 kundër dhe 2 abstenime miratohet pika e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të të komunës me pronë private në emër të z. Ismet Halimaj.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- prezanton pikën e rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emër të Arsim Avdijaj.

Kryesuesi i Kuvendit- kush dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Negjdet Ramaj e ka kërkuar fjalën?

Negjdet Ramaj- desha ta di ajo parcela e komunës a është e uzurpuar apo është e lirë, pra kjo që po doni të ja jepni z. Arsim Avdijaj, dhe trotuarin që po e cek aty a e keni marrë ju, apo është larguar ai vet, si ka ndodhë kjo? Sepse po më duket që po i marrim disa vendime, që me të vërtetë po bëhen pazare politike, por falë njerëzve të mençur MAPL-ja i kontrollon këto gjëra edhe është hierarkia e vendimmarrjes dhe po i kthejnë po i kontrollojnë. Është mirë të sqarohen këto gjëra. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Agon Dreshaj- pjesën e trotuarit e ka marrë komuna për projektin e vet. Nuk ka asnjë lloj pazari Negjdet, hierarkia ekziston por edhe gjykata ekziston, ne nuk e kemi bërë si komunë, por shume komuna e bëjnë shpesh këtë që rastet që kthehen nga MAPL-ja i dërgojnë në gjykatë, edhe për kto vendimmarrja është e Kuvendit, dhe le ta vlerësojë gjykata.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- unë kam informata që është uzurpuar ajo pjesë mbrapa “Jafa Market” ku po doni të ja jepni personit në fjalë. Edhe më herët kur e ceke për atë pronën në Gurrakoc, thoshe po duam ta bëjmë win-win, dhe doli që është gabim, se aty ka shtëpia të ndërtuara në tokë të komunës dhe është dashur të ceket, nëse doni të bëni legalizim të shtëpiave kisha qenë edhe unë për atë me ja legalizuar personit në fjalë, po jo me ardhur në atë variantin me i vënë njerëzit në lajthitje, po e rregullojmë lumin e lumi është një kilometër larg asaj parcele. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- këtu është thënë nga një këshilltar që ajo është afër lumit, më ka vënë në lajthitje edhe mua, e unë e kam qortuar drejtorin që nuk ka treguar tani i them ku janë ato prona.

Agon Dreshaj- gabimi ka qenë te emri i lumit se është thënë lumi “Istogu” ne kemi folur për lum por nuk është përmendur lumi “Istogu”.

Kryesuesi i Kuvendit- por aty është do ujë që kalon, si e ka emrin nuk e di. A dëshiron edhe dikush të diskutoj? Pasi që jo, e hedh në votim, kush është që të miratohet ky vendim?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota për 3 kundër dhe 2 abstenime miratohet pika e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të të komunës me pronë private në emër të z. Arsim Avdijaj.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- kemi pikën e rendit të ditës që u propozua për mbledhjen e sotme, njoftim me rekomandimin e ministrisë të Financave Punës dhe Transfereve lidhur me propozimin e këshilltarit Negjdet Ramaj, për lirimin e anëtarëve të familjeve të veteranëve. E kisha ftuar drejtorin Genc Ademaj që të na jap në mënyrë analitike këtë.

Genc Ademaj- unë propozoj që te neni 15 i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha të futet një paragraf i ri, i cili duhet të jetë në harmonizim me Ligjin Nr.04 L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve, Pjestarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe familjeve të tyre nga taksat administrative komunale. Të mbetet ky harmonizim.

Kryesuesi i Kuvendit- e kemi edhe propozimin e Andi Xhuraj, ajo nuk ka hy në Komitet për Politikë dhe Financa nuk e di a është e ligjshme për çështjen e lirit të pjestarëve të Policisë që me e fut direkt?

Genc Ademaj- kjo mundet të jetë pjesë e këtij paragrafi, si vazhdim i fjalisë që të shtohet edhe lirimi i pjestarëve të Policisë në nivel të komunës, pra mundet me u përfshirë edhe kjo, është taksë komunale, ato janë të hyrat tona, kështu që mundemi ta bëjmë. Kisha kërkuar nga ju, që emërimin e saktë ta bëjmë bashkë me zyrtarët ligjor, vetëm që i përcaktuam së bashku kategoritë cilat janë ato. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- pra u pajtuam rreth kësaj çështje. Kush është që të miratohen propozimet e Negjdet Ramaj dhe Andi Xhuraj?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota për 0 kundër dhe 0 abstenime miratohet propozimet e Negjdet Ramaj dhe Andi Xhuraj.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit- sqarimin e dha drejtori kur e propozoi si pikë të rendit të ditës. A ka dikush diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës? Pasi që jo e hedh në votim? Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 15 vota për 4 kundër dhe 5 abstenime miratohet pika e rendit të ditës, Rishqyrtimi i Vendimit lidhur me kërkesën e KRM "Ambienti" njësia operative Istog për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Deri me datën 22 shkurt ka qenë e hapur thirrja nga ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për përcaktimin e lokacionit për ndërtimin e ndërtesës së banimit të përballueshëm. A keni arritur që si ekzekutiv t'i kompletioni dokumentet e kërkuara dhe ta bëni aplikimin me kohë? Ka ankesa nga bizneset, të cilat veprimtarinë e tyre e kanë me mbeturina të ngurta, kompania nuk është duke ju ofruar zgjidhje, kërkoj nga ekzekutivi t'i ofrohet zgjidhje për bizneset në përgjithësi që i ushtrojnë veprimtaritë e tyre dhe të jemi korrekt me ta. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- po komuna ju është përgjigjur thirrjes së ministrisë, e kemi dërguar komplet dokumentacionin çka kanë kërkuar. Tani po presim përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- për këtë mbledhje unë i kam këto kërkesa dhe pyetje. Është kërkesë nga banorët e fshatit Vrellë për një dëgjim publik për të vendosur fshati rreth fatit të objektit të ish çerdhes së vjetër që gjendet në qendër të fshatit. Momentalisht objekti është duke i shkatërruar gjatë natës, dhe sipas banorëve është kthyer në një strehë për njerëzit që mund të përdorin edhe substanca të ndaluara. Nëse ndalohet me kohë shkatërrimi i saj, mund të shfrytëzohet varësisht prej kërkesave të banorëve gjatë atij dëgjimi si p.sh ndonjë qendër rinore apo zyre fshati. Kam një kërkesë nga një qytetarë me nevoja të veçanta i cili thotë që has në vështirësi për kycjen në trotuar për shkak të lartësisë së skajoreve kryesisht në qendër dhe kërkon me e pas në konsideratë në të ardhmen edhe këtë kategori. Si dhe një pyetje tjetër nga banorët e bashkësisë lokale në Vrellë që pyesin a do të funksionalizohet zyra e vendit në Vrellë dhe shërbimet të japen nga zyra në Vrellë meqë objekti është dhe ka funksionuar edhe më herët deri në rastin që jemi të njoftuar edhe më herët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- për objektin e ish çerdhes në Vrellë, janë këtu edhe drejtori i Arsimit edhe drejtoresha për Mirëqenie Sociale, e kemi vizituar bashkë me një ekip të “NALAS” dhe Asociacionit të Komunave që po tentojnë ta bëjnë një qëndrim ditor për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe për shkak të mungesës së objekteve të tilla kemi propozuar që të jetë ish çerdhja në Vrellë. Jemi të gatshëm që ta bashkëfinancojmë renovimin dhe funksionalizimin e asaj qendre. Te pyetja tjetër, skajoret, është e vërtetë që ka mbetur keq, por do të shtrohet edhe një pjesë e asfaltit dhe pastaj do bëhet nivelizimi i duhur. (Jep sqarime shtesë lidhur me pyetjen.) Si dhe sa i përket zyrës e gjendjes Civile, është një obligim që duhet ta zbatojnë komunat që zyret e vendit të mbyllen në zonat urbane dhe të kalojnë të gjitha në një lokacion të vetëm për shkak të sigurisë së të dhënave të qytetarëve. Urdhëresa është që të bashkohen të gjitha në Istog në një lokacion. Rifunksionalizimi i tyre është i pamundur sepse nuk e lejon as ministria. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- këto pyetje që dua ti adresoj i kam bërë edhe më herët. Pyetja parë është, kur do të vazhdoj puna në palestrën sportive në Vrellë, sepse faktikisht aty janë ndërprerë punimet dhe janë prishur kontratat, objekti ka mbetur i pa shfrytëzuar. Pyetja e dytë, ka lidhje me çerdhen që është afër policisë, edhe kjo ka mbetur si një objekt që është i pa shfrytëzuar, mund t'i keqpërdoret nga shumë kush, meqenëse është e nevojshme, ka numër të madh të familjeve që kërkojnë strehim të fëmijëve të tyre, kur do të funksionalizohet apo punohet diçka në këtë drejtim. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtoresha Vlora Vuthaj.

Vlora Vuthaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket palestrës sportive në Vrellë veç e kemi projektin e gatshëm, është shkëputur kontrata që ka qenë paraprakisht, projekti është i gatshëm dhe besoj gjatë muajit Mars do kalojë në procedura të prokurimit e pastaj me filluar punimet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- sipas ministrisë dhjetë kontrata kanë shkuar për shkëputje që e kanë të njëjtin problem si ne, në mesin e tyre është edhe çerdhja jonë, gjithmonë në koordinim me ish punë kryesin që kanë arritur marrëveshje për shkëputje të kontratës, dhe besoj shumë shpejt sipas ministrisë do të dalë në tender edhe do të fillojnë punimet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë, kur do të vazhdoj punën në kanalet e ujitjes në fshatrat Llukac i Begut dhe Lluga pasi që punimet kanë filluar që një kohë të gjatë edhe banorët duan ta dinë kur të vazhdoj puna në pjesën tjetër të mbetur. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- ne e kemi bërë një ri tenderim dhe fatkeqësisht ofertat kanë ardhur mbi shunën e planifikuar, tani këtë vit projekti bartet prapë, ai projekt besoj nga gjysma e verës nëse kryhet bartja me kohë tenderohet sërish dhe urojmë të planifikohet mirë projekti dhe mos të përsëritet, është projekt nga të hyrat që bartet deri në momentin që realizohet. Kjo është arsyeja që ka mbetur pa u realizuar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

5.Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF i përgjigjet Drejtorisë Komunale për Shëndetësi. Neni 16 1.Drejtori ka për detyrë që, gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të tërheqë vëmendjen: 1.1.Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht, në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF; 1.2.Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin e punës së QKMF; 1.3.Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit. Neni 17 Trupat e QKMF 1.Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF, formon Trupa Profesionale në QKMF, siç janë: 1.1Këshilli Profesional; 1.2.Komisioni Disiplinor i QKMF; 1.3.Komisioni i Ankesave i QKMF; 1.4.Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore;	2.6.Enables Continuous Professional Development and training of the MFMC staff; 2.7.Manages the implementation of quality standards; 2.8.Contributes to the development and implementation of the MFMC health information system. 3.The work program of the MFMC is implemented based on the health system development policies drafted by the MoH. 4.In the annual work program must be defined the objectives, activities and expected results in the MFMC, such as: 4.1. Annual work plan; 4.2. Organization and administering; 4.3. Human Resources; 4.4. Financial Plan; 4.5.Monthly, annual work reports and financial statements. 5.For the performance of his duties, the director of MFMC reports to the Municipal Directorate of Health and Social Welfare. Article 16	5.Za izvršavanje svojih poslova, direktor GCPM odgovara Opštinskoj Direkciji za zdravstvo i socijalnu zaštitu. Član 16 1.Direktor ima zadatak da tokom rada i odluka koje donosi Upravni savet, skrene pažnju: 1.1.Ukoliko su predloženi akti u suprotnosti sa relevantnim zakonima, odnosno u suprotnosti sa opštim aktima GCPM-a; 1.2.Ukoliko je predloženi akt u suprotnosti sa Programom rada GCPM-a; 1.3.Ukoliko predloženi akt ne doprinosi cilju. Član 17 Tela GCPM-a 1.Da bi ispunio posebne zadatke, Upravni savet, preko direktora GCPM-a, formira profesionalna tela pri GCPM-u, kao što su: 1.1.Profesionalni savet; 1.2.Disciplinska komisija GCPM-a; 1.3.Komisija za žalbe GCPM-a; 1.4.Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga;
---	---	--

1.5.Komisioni Etiko – Profesional. 2.Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF. 3.Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF. Neni 18 Këshilli Profesional 1.Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i Drejtorit të QKMF-së. 2.Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektorëve dhe Njësive, Shefit të Barnatores qendrore si dhe Kryeinfermieri/ja e QKMF-së, sipas nenit 9 të këtij Statuti. 3.Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF. 4.Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit. 5.Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:	1.The Director has the duty to draw attention during the work and decisions taken by the Board of Directors: 1.1.If the proposed acts are contrary to the relevant laws, respectively, contrary to the general acts of the MFMC; 1.2.If the proposed act is in conflict with the work Program of the MFMC; 1.3.If the proposed act does not contribute to the objective. Article 17 MFMC Bodies 1.For the fulfillment of special tasks, the Board of Directors, through the director of MFMC, establishes Professional Bodies in MFMC, such as: 1.1.Professional Council; 1.2.MFMC Disciplinary Commission; 1.3.MFMC Complaints Commission; 1.4.Committee on Quality and Safety of Health Services; 1.5.Professional Ethics Commission.	1.5.Etičko – profesionalna komisija. 2.Članove stručnih tela imenuje direktor GCPM-a. 3.Upravni savet, preko direktora GCPM-a, prema potrebi, može da formira i druga profesionalna tela u GCPM-u. Član 18 Profesionalni savet 1.Profesionalni savet je savetodavno telo direktora GCPM-a. 2.Profesionalni savet se sastoji od rukovodioca Odeljenja, rukovodioca Sektora i Jedinica, šefa centralne Apoteke kao i glavne medicinske sestre GCPM-a, prema članu 9. ovog Statuta. 3.Predsednik Profesionalnog saveta, prema službenoj dužnosti, je rukovodilac Odeljenja porodične medicine GCPM-a. 4.Stručni savet izrađuje Pravilnik o radu Saveta. 5.Predsednik Stručnog saveta obavlja ove poslove: 5.1.Priprema, saziva i vodi sastanke Stručnog saveta;
---	--	--

5.1.Përgatit, thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional; 5.2.Verifikon rendin e ditës së takimeve; 5.3.Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve. 6.Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërrasë mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF. 7.Këshilli Profesional i QKMF, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra: 7.1.Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike; 7.2.Propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë; 7.3.Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale; 7.4.Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale	2.The members of the professional bodies are appointed by the Director of MFMC. 3.The Board of Directors, if necessary, may establish other professional bodies in the MFMC through the Director of MFMC. Article 18 Professional Council 1.The Professional Council is an advisory body to the MFMC Director. 2.The Professional Council consists of the Heads of Departments, the Heads of Sectors and Units, the Head of the Central Pharmacy and the Head Nurse of the MFMC, in accordance with article 9 of this Statut. 3.According to the official duty, the Head of the Department of Family Medicine of MFMC is the Chairman of the Professional Council. 4.The Professional Council drafts the Rules of Procedure for the work of the Board. 5.The Chairman of the Professional Council performs the following tasks: 5.1.Prepare, convenes and chairs the meetings of the Professional Council;	5.2.Utvrdhje dnevni red sastanaka; 5.3.Obezbeđuje vođenje zapisnika na sastancima. 6.Predsednik Stručnog saveta je obavezan da sazove sastanak u roku od 3 (tri) dana, od trenutka kada to zahteva direktor GCPM-a. 7.Profesionalni savet GCPM-a, osim zadataka predviđenih zakonom, obavlja i ove zadatke: 7.1.Razmatra i odlučuje o potrebama i profesionalnim razlozima za primenu novih dijagnostičkih i terapijskih metoda i postupaka; 7.2.Predlaže Upravnom savetu i direktoru preduzimanje stručnih mera za poboljšanje organizovanja rada i uslova za razvoj delatnosti; 7.3.Predlaže strukturu unutrašnjeg nadzora, u vezi sa radom zdravstvenih radnika kao i mere za poboljšanje profesionalnog rada; 7.4.Razmatra potrebu za kontinuirani profesionalni razvoj i predlaže direktoru da se zdravstveni radnici šalju na profesionalno obučavanje;
--	---	---

7.5.Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuritë e fituara nga ZhVP; 7.6.Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional. Neni 19 Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore 1.Në QKMF funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore. 2.Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (në vazhdim vetëm Komiteti) është një ekip multi-disciplinar i cili përbëhet nga: 2.1.1Drejtori i institucionit; 2.1.2 Kryeinfermieri në QKMF; 2.1.3Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore; 2.1.4 Kryeshefi i Departamentit në MF; 2.1.5Kryeshefi i administratës në KPSH; 2.2Varësisht nga institucioni shëndetësor, ky komitet mund të ketë edhe anëtarë të tjerë; 2.3Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit janë të bazuara në dispozitat e statutit të institucionit shëndetësor.	5.2.Verifies the agenda of meetings; 5.3.Ensures that the minutes of the meetings are kept. 6.The Chairman of the Professional Council is obliged to call the meeting within 3 (three) days, from the day upon which this is requested by the director of the MFMC. 7.In addition to the duties provided by law, the Professional Council performs also these duties: 7.1.Reviews and decides on the need and professional reasons for the implementation of new diagnostic and therapeutic methods and procedures; 7.2.Proposes to the Board of Directors and the director taking of professional measures to improve the organization of work and conditions for the conduction of the activity; 7.3.Proposes the structure of internal supervision, related to the work of health employees as well as measures for improving the professional performance; 7.4.Reviews the need for continuous professional development and proposes to the director the sending of health employees to professional development programs/opportunities;	7.5.Traži pismeni izveštaj od zdravstvenih stručnjaka o znanju stečenom od KPR-a; 7.6.Razmatra i odlučuje o ostalim pitanjima, koja direktor postavlja pred Upravnim savetom. Član 19 Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga; 1.U GCPM funkcioniše Komitet za obezbeđivanje kvaliteta zdravstvenih usluga. 2.Komitet kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga (u nastavku samo Komitet) je više-disciplinska ekipa koja se sastoji od: 2.1.1 Direktora ustanove; 2.1.2. Direktora nege, Glavne sestre u GCPM-u; 2.1.3. Koordinator za obezbeđivanje kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga; 2.1.4. Direktor zdravlja, Glavni šef odeljenja u PM-u; 2.1.5. Operativni-administracioni direktor, Glavni šef administracije u ISZ-u; 2.2.Zavisno od zdravstvene ustanove, ovaj komitet može imati i druge članove;
--	--	---

Neni 20 Komisioni Etik-Profesional Komisioni Etik - Profesional është trup i cili denoncon rastet e shkeljeve sipas ligjit për odat e profesionistëve shëndetësor. Neni 21 Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH. Neni 22 Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional 1. Institucionet shëndetësore në KPSH janë të obliguara që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë. 2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSH, dhe zbatohet sipas planprogramit, të aprovuar nga Odat e Profesionisteve Shëndetësorë.	7.5.Requires written reports from health professionals on the knowledge gained from the CPD; 7.6.Reviews and decides on other matters, which are submitted to the Professional Council by the director. Article 19 Committee on Quality and Safety of Health Services 1. There is a Committee on Quality and Safety of Health Services which operates within the MFMC. 2. The Committee on Quality and Safety of Health Services (hereinafter referred to only as: the Committee) is a multi-disciplinary team consisting of the: 2.1.1 Director of Institution; 2.1.2 Director of Nursing Ward, Head Nurse at the MFMC; 2.1.3 Coordinator for ensuring the quality and safety of health services; 2.1.4 Health Director, Chief of Department in the PHC; 2.1.5 Director of Operations-Administration, Chief of Administration in the PHC;	2.3.Zadaci i odgovornosti komiteta su osnovane prema odredbama statuta zdravstvene ustanove. Član 20 Etičko-profesionalna komisija Eričko-profesionalna komisija je telo koje osuđuje slučajeve kršenja po zakonu za komore zdravstvenih stručnjaka. Član 21 Zadaci i odgovornosti ostalih tela se određuju podzakonskim aktima, usvojenih od Upravnog saveta, preko direktora GCPM-a, ukoliko one nisu određene ostalim aktima od strane MZ. Član 22 Kontinuirani profesionalni razvoj 1.Zdravstvene ustanove u ISZ-u su dužne da omogućće i podrže kontinuiran stručni razvoj njihovih zdravstvenih radnika. 2.Kontinuirani stručni razvoj je obavezan za sve zdravstvene stručnjake u ISZ-u, i primenjuje se prema planu i programu usvojenom od Komore zdravstvenih stručnjaka.
---	--	--

3.Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas Termave të Referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë. 4.Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi. VI-Mbikëqyrja e QKMF Neni 23 Llojet e mbikëqyrjes në QKMF 1.QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me dispozitat në fuqi që sigurohet përmes DKSh dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. 2.Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e propozon Këshilli Drejtues i QKMF. 3.Mbikëqyrja e QKMF përfshin:	2.2 Depending on the health institution, this committee may have other members, as well; 2.3 The duties and responsibilities of the committee are based on the provisions of the statute of the health institution. Article 20 Professional Ethics Commission The Professional Ethics Commission is a body that reports the cases of violations pursuant to the law on chambers of healthcare professionals. Article 21 Duties and responsibilities of other bodies are defined by sub-legal acts, issued by the Board of Directors, through the Director of MFMC, if they are not defined by other acts of the MoH. Article 22 Continuous Professional Development 1.Health institutions in the PHC are obliged to enable and support the continuous professional development of their health employees.	3.Za razvoj aktivnosti, iz stava 2 ovog člana 31, odgovorni su koordinatori i treneri u Programima porodične medicine i porodične nege, koji treba da imaju adekvatno akademsko i profesionalno zvanje i koji se određuju po opisu zadatka izrađenom od Ministarstvu zdravlja. 4.Finansiranje KPR-a zdravstvenih stručnjaka se obavlja iz budžeta GCPM-a i ostalih izvora na osnovu normativnih akata na snazi. VI- Nadzor GCPM-a Član 23 Vrste nadzora u GCPM-u 1.GCPM se podvrgava unutrašnjem i spoljnom nadzoru u skladu sa odredbama na snazi koje pružaju, koje se osigurava preko ODZSZ-a i vlasti određene od Ministarstvo zdravlja. 2.Unutrašnji nadzor stručnog rada se obavlja na način predviđen Pravilnikom o unutrašnjem nadzoru, koji predlaže Upravni savet GCPM-a. 3.Nadzor GCPM-a uključuje:
--	--	--

3.1.Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve; 3.2.Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria; 3.3.Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe rregullat e Prokurimit Publik. VII- Aktet nga veprimtaria e Institucionit Neni 24 Aktet e përgjithshme 1.Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF nxjerr këto akte të përgjithshme: 1.1.Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; 1.2.Rregulloren për punë; 1.3.Rregulloren për mbrojtjen në punë; 1.4.Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit; 1.5.Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;	2.Continuous professional development is mandatory for all health professionals in the PHC, and is implemented according to the curriculum, approved by the Chambers of Health Professionals. 3.Persons responsible for conducting the activities, from paragraph 2 of this article are the Coordinators and trainers in the Family Medicine and Family Nursing Programs, who must have adequate academic and professional training and are appointed pursuant to the Terms of Reference drafted by the Ministry of Health. 4.The financing of CPD of health professionals is carried out using the MFMC budget and other sources based on normative acts in force. VI- Supervision of the MFMC Article 23 Types of supervision in the MFMC 1.The MFMC is subject to internal and external legal and professional supervision in accordance with the provisions, which is ensured through the MDHSW and authorities designated by the Ministry of Health	3.1.Nadzor i obavljanje inspekcije objekata PZN-a za infrastrukturu i rukovodstvo objekata; 3.2.Nadzor i obavljanje inspekcije pružanja kvalitetnih zdravstvenih usluga, prema normama i standardima određenih od Ministarstva; 3.3.Nadzor i nadgledanje finansijskih izveštaja i procedura, za upravljanje izdvojenim fondom, predviđenim od Ministarstva zdravstva, Ministarstva finansija i pravilima Javne nabavke. VII- Akti za delatnost institucije Član 24 Opšti akti 1.Na predlog direktora, Upravni savet GCPM-a usvaja ove opšte akte: 1.1.Pravilnik o unutrašnjem organizovanju i sistematizaciji radnih mesta; 1.2.Pravilnik o zaštiti na radu; 1.3.Pravilnik o zaštiti na radu; 1.4.Pravilnik o zaštiti protiv požara; 1.5.Pravilnik o unutrašnjem računovodstvu; 1.6.Pravilnik o kućnom redu; 1.7.Pravilnik o unutrašnjem nadzoru;
---	---	---

1.6.Rregulloren për rendin shtëpiak; 1.7.Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme; 1.8.Rregulloren për parandalimin e infeksioneve; 1.9.Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF. VIII- Pronësia, Buxheti dhe Financat Neni 25 Pronësia 1.QKMF ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Komunes e Istogut. 2.QKMF si institucion i KPSH është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Kosovës. 3.Pasurinë e QKMF e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF ka të drejtë të disponojë në pajtim me aktet ligjore në fuqi. Neni 26 Buxheti	2.Internal supervision of professional work is carried out in the manner provided by the regulation on internal supervision, which is proposed by the Board of Directors of the MFMC. 3.Supervision of the MFMC includes: 3.1.Supervision and inspection of PHC facilities regarding the infrastructure and management of facilities; 3.2.Supervision and inspection of the provision of quality health services, according to the norms and standards set by the Ministry; 3.3.Supervision and monitoring of financial reports and procedures, in relation to the management of the allocated fund, provided by the Ministry of Health, Ministry of Finance and Public Procurement rules. VII- Institution activity acts Article 24 General acts 1.At the proposal of the Director, the MFMC Board of Directors issues the following general acts: 1.1.Regulation on internal organization and systematization of job positions;	1.8.Pravilnik o sprečavanju infekcija; 1.9.Ostale Pravilnike o radu u GCPM-a. VIII- Imovina, budžet i finansije Član 25 Imovina 1.GCPM koristi sredstva i imovinu, koja je imovina Skupštine Opštine. 2.GCPM kao institucija PZN-a je korisnik fonda za finansiranje iz budžeta Kosova. 3.Imovinu GCPM-a čine oprema, prava i materijalna dobra, sa kojima GCPM ima pravo da raspolaže u skladu sa zakonskim aktima na snazi. Član 26 Budžet 1.Budžetska i finansijska pitanja GCPM se upravljaju na transparentan način, u skladu sa uredbama o korišćenju fondova iz budžeta Kosova, kao i sa svim procedurama, u skladu sa uputstvima Ministarstva finansija.
---	--	---

1.Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me legjislacionin në fuqi për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave. 2.Buxheti dhe llogaritë e QKMF përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese. 3.Prokurimi i QKMF bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhe akteve nën-ligjore. 4.Drejtori mund të kërkojë Drejtorit të Drejtoratit të Shëndetësisë auditim të brendshëm për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve. Neni 27 Financimi 1.QKMF shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Buxheti i Komunave dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse. 2.Procedura dhe forma e bashkëpagesës për shërbimet e ofruara në QKMF përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi.	1.2.Rules of procedure; 1.3.Regulation on protection at work; 1.4.Fire Protection Regulation; 1.5.Regulation on internal accounting; 1.6.Regulation on house rules; 1.7.Regulation on internal supervision; 1.8.Regulation on prevention of infections; 1.9.Other regulations on the progress of work in the MFMC. VIII-Ownership, Budget and Finance Article 25 Ownership 1.The means and property in use by the MFMC are in the ownership of the Municipal Assembly. 2.The MFMC as an institution of PHC is the beneficiary of the financing fund from the Kosovo Budget. 3.The property of MFMC consists of assets, rights and material goods, which the MFMC is entitled to possess in accordance with the legal acts in force.	2.Budžet i računi GCPM-a obuhvataju sve operative troškove radnih jedinica. 3.Nabavka u GCPM se obavlja u skladu sa pravilima Javne nabavke prema Zakonu na snazi i podzakonskim aktima. 4.Direktor može da zahteva spoljnu reviziju i da posmatra pravilno korišćenje sredstava. Član 27 Finansiranje 1.GCPM koristi finansijske izvore u skladu sa Zakonom o zdravstvu Kosova, Zakonom o lokalnoj samoupravi, iz budžeta Kosova, budžeta opština i iz ostalih izvora predviđenih dotičnim zakonima. 2.Procedura i oblik participacije za usluge pružene u GCPM-u se određuju podzakonskim aktom na osnovu Zakona o zdravstvu. Član 28 Dodatak Dodatak1 je sastavni deo ovog Statuta.
--	---	--

Neni 28 Shtojca Aneksi 1 është pjesë përbërëse e këtij Statuti. IX- Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare Neni 29 Perioda kalimtare dhe shfuqizimi 1.Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me këtë Statut. 2.Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF-Istog viti 2017. Neni 30 Shkurtesat - M.Sh- Ministria e Shendetësisë; - KPSH- Kujdesi Parësor Shëndetësorë; - QKMF- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare; - QMF- Qendra e Mjekësisë Familjare; - AMF- Ambulanca e Mjekësisë Familjare; - SSSh - Strategjia Sistemit Shendetësorë; - SISH- Sistem Informativ Shendetësor;	Article 26 Budget 1.MFMC budgetary and financial issues relating to the the use of funds from the Kosovo Budget are administered in a transparent manner, in accordance with the legislation in force and all procedures, pursuant to the guidelines of the Ministry of Finance. 2.The budget and MFMC financial accounts include all operating expenses of the working units. 3.Procurement in the MFMC is carried out in accordance with the rules of Public Procurement pursuant to the Law in force and sub-legal acts. 4.The director may request an external audit and monitor the proper use of the funds. Article 27 Financing 1.In accordance with the Law on Health of Kosovo, the Law on Local Self-Government,	IX- Prelazne i završne odredbe Član 29 Prelazni period i obesnaživanje 1.Do usvajanja podzakonskih akata na osnovu ovog Statuta ostaju na snazi postojeći akti koji nisu u suprotnosti sa ovim Statutom. 2.Stupanjem na snagu ovog Statuta obesnažuje se Statut GCPM-a u (ime dotične opštine), ____godine. Član 30 Skracenice - M.Z – Ministarstvo Zdravstva; - PZN- Primarna Zdravstvena Nega; - GCPM- Glavni Centar Porodicne Medicine; - CPM – Centar Primarne Medicine; - APM – Ambulanta Primarne Medicine; - SZS- Strategija Zdravstvenog Sistema; - ISZ- Informativni Sistem Zdravstva; - KPR – Kontinuirani Profesionalni Razvoj.
--	---	---

- ZHVP- Zhvillimi Vazhdushëm Profesional; Neni 31 Hyrja në fuqi Ky Statut hyn në fuqi.....	the MFMC uses the financial resources from the Kosovo Budget, Budget of Municipalities and other sources, as provided for by relevant laws. 2.The procedure and form of co-payment for the services provided at the MFMC is determined by a sub-legal act based on the Law on Health. Article 28 Annex 1 Annex 1 is an integral part of the present Statute. IX- Transitional and final provisions Article 29 Transitional period and repeal 1.Until the issuance of sub-legal acts based on this Statute, the acts that are in force and that are not in conflict with this Statute shall remain in force. 2.Upon the entry into force of this Statute, the Statute of the MFMC in (the name of the respective municipality) is repealed, year - ____.	Član 31 Stupanje na snagu Ovaj Statut stupa na snagu.....
---	--	---

	Article 30 Entry into force This Statute enters into force.....	
--	---	--



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova**



**Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog**

KOMUNA ISTOGUT

DRAF-STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)

Shkurt, 2024

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje

Kontaktet:



Numri pa pagës 080019999 – Policia e Kosovës /
044/049 - 278809 Shtëpia e Sigurtë /
039 - 451140 – Qendra për Punë Sociale /
192 - Thirrjet emergjente/

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1:	HYRJE PËRMBLEDHËSE
KAPITULLI 2:	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE STRATEGJISË
KAPITULLI 3:	ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE
KAPITULLI 4:	KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA
KAPITULLI 5:	AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË
KAPITULLI 6:	PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM
SHTOJCA 1:	PLANI I VEPRIMIT

FALENDERIME

Draft - Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 – 2027), është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Istogut, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Grupi Punues për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, falënderon veçanërisht institucionet komunale për kontributin e dhënë ku vlerësojnë me prioritet masat për parandalimin e dhunës në familje, në këtë rast falënderojmë drejtoritë përkatëse të komunës së Istogut si dhe Mekanizmin Koordinues kundër Dhunës në Familje.

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen

KAPITULLI I

HYRJE PËRMBLEDHËSE

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Istogut, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë.

Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj. Tërë këto çështje përmbajnë problematika që duhen zgjidhur përmes proceseve të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Strukturat vendimmarrëse, së bashku me organizatat joqeveritare, kanë detyrime në zbatim të kësaj strategjie, të cilat rrjedhin nga funksionet specifike dhe roli që luajnë në shoqëri. Ky dokument synon të japë ndihmesën e saj në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve të Dhunës në Familje, si pjesë e përpjekjeve të Komunës së Istogut.

Kjo strategji i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimores që mbështetin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Istogut të strehuara si viktimat të dhunës në familje

Hartimi i kësaj strategjie është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal.

KAPITULLI II

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË STRATEGJISË KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera të papunësisë, të lëvizjeve demografike, të koncepteve të ndryshme mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore. Prandaj, Komuna jonë ka nevojë që të hartoj këtë strategji me anë të së cilës synojmë një shoqëri ku secili respektohet si duhet dhe të jetë në gjendje të realizojë potencialin që ka, pa dhunë dhe diskriminim.

Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Istogut, synon të:

- ☐ Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ☐ Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- ☐ Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- ☐ Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Fushat e veprimit dhe objektivat strategjike të këtij dokumenti janë:

Fushat e Veprimit A.

ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon që të kontribujë në ndryshimin e qasjes në familje dhe shoqërisë për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje.

Fushat e Veprimit B.

ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon një komunitet të mirë informuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë, të aftë dhe të përgatitur për trajnimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në përgjithësi.

Fushat e Veprimit C.

FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqenien e të mbijetuarave të Dhunës në Familje dhe të familjeve të tyre.

Fushat e Veprimit D.

FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon të ketë një koordinim më të mirë për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Çdo objektiv strategjik është zbrëthyer më tej në disa objektiva specifike, për të cilat është zhvilluar një plan veprimi i detajuar me aktivitete, institucionet përgjegjëse dhe partnere si dhe vlerësime të tjera që lidhen me afatet kohore të zbatimit, kostot dhe planin e monitorimit.

KAPITULLI III

ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në formë dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Istogut ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që ndikojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshme në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Istogut, krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit, është 50% me 50%.

Duke pasur parasysh trendët e varfërisë, shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Istogut, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Istogut ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të të papunësuarve dhe nivelin më të ulët arsimor. Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i të punësuarve në Institucionet Komunale është 195 të shërbimit civil, nga kjo shifër vetëm femra janë 64 , duke përfshi edhe komunitete jo shumicë që kanë shifrën 12 të punësuar, nga kjo shifër janë 8 femra dhe 4 meshkuj. Kjo shifër tregon se gjendja ekonomiko sociale nuk është në nivel të kënaqshëm.

Probleme sociale të lidhura me dhunën në familje: Martesat e hershme janë një ndër dukuritë evidente në komunën e Istogut që prek vajzat dhe djemtë, ndonëse vajzat janë në numër më të madh dhe përballen me pasoja më të shumta. Martesat e hershme privojnë të rinjtë, e sidomos vajzat nga arsimimi dhe zhvillimi i perspektivave afatgjata. Vajzat lindin fëmijë në moshën e tyre më të hershme, mbeten të izoluar nga shoqet, shokët dhe familja e tyre. Gratë e reja nuk mund të dalin vetëm, pa pajtimin e burrit apo anëtarëve tjerë të familjes dhe nuk fitojnë të ardhura, po ashtu si shkakton ekonomik është edhe ndarja jo e barabartë nga trashëgimia familjare pikërisht kemi cenim ndaj të drejtave të njeriut dhe diskriminim gjinore duke i trashëguar paragjykimet dhe stereotipet , ndaj mbeten të varura ekonomikisht dhe nuk janë vendimmarrëse në ekonominë familjare. Për këto arsye, këto gra të reja janë më të prekura nga dhuna në familje. Sipas disa të dhënave, numri i rasteve të paraqitura në Qendrën për Punë Sociale (QPS) – Istogut për dhënien e pëlqimit për martesë të hershme ndryshon:

viti 2021: Numri i rasteve - 2

viti 2022: Nuk ka pasur raste

viti 2023: Numri i rasteve - 1

Numri i rasteve është dukshëm më i madh, por për shumë prej tyre nuk ka raportime.

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisht më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

RRITJA E DIVORCEVE NË SHOQËRI: Numri i divorceve ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2021 ka pasur 24 kërkesa për divorc, në vitin 2022 kanë qenë 38 kërkesa, ndërsa në vitin 2023 janë 22 kërkesa. Sa i përket rritjes së numrit të divorceve nga viti në vit, nuk kemi arritur të nxjerrim ndonjë përfundim, këto statistika janë nga Qendra për Punë Sociale.

Nga tregues statistikor, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Shtëpinë e Sigurtë edhe pse kjo Shtëpi e Sigurtë mbulon Regjionin e Istogut për vitin 2021 janë strehuar gjithsej 8 gra dhe 5 fëmijë, prej tyre 6 gra dhe 3 fëmijë nga komuniteti shqiptar, 1 grua dhe 2 fëmijë nga komuniteti rom si dhe 1 grua nga komuniteti boshnjak. Ndërsa në vitin 2022 janë strehuar 3 gra dhe 2 fëmijë gjithsej, prej tyre 1 grua nga komuniteti shqiptar, 1 nga komuniteti boshnjak, 1 grua nga komuniteti rom. Në vitin 2023 janë strehuar gjithsej 11 gra dhe 8 fëmijë, prej tyre 6 gra nga komuniteti shqiptar, 3 komuniteti rom dhe 2 nga komuniteti boshnjak ndaj të cilave është ushtruar dhunë në familje, qëndrimi i këtyre viktimave nuk është e definuar në mënyrë të saktë, sepse ndodhin raste që të qëndrojnë edhe me tepër se 6 muaj deri në Vendimet Gjyqësore

Në bazë të statistikave nga Policia e Kosovës raportohet se në vitin 2021 kemi pas 73 raste të dhunës në familje, prej tyre 63 janë viktime femra dhe 13 viktime meshkuj, nga të cilët 56 nga komuniteti Shqiptar , 5 Ashkali dhe 15 Egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

16-20 vjeç janë 7 raste
20-30 vjeç janë 13 raste
30-40 vjeç janë 30 raste
40-50 vjeç janë 16 raste
50-60 vjeç janë 6 raste
60-70 vjeç janë 3 raste
70-80 vjeç janë 2 raste

Ndërsa në vitin 2022 raportohet se kemi pasur 47 viktime të dhunës në familje prej tyre 41 femra dhe 6 meshkuj, nga të cilët 37 nga komuniteti shqiptarë, 1 boshnjak, 2 rom dhe 6 egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

0-18 janë 3 raste
18-20 janë 2 raste
20-30 janë 18 raste
30-40 janë 8 raste
40-50 janë 7 raste
50-60 është 2 raste
70-80 është 1 rast

Ndërsa në vitin 2023 raportohet se kemi pasur 67 viktime të dhunës në familje prej tyre 49 femra dhe 18 meshkuj, nga të cilët 49 nga komuniteti shqiptarë , 4 boshnjak, 1 rom, 3 ashkali dhe 9 egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

0-18 janë 15 raste
18-20 janë 2 raste
20-30 janë 13 raste
30-40 janë 21 raste
40-50 janë 8 raste
50-60 janë 4 raste
60-70 janë 3 raste
70-80 janë 2 raste

Pasi që qëndrimi në strehimoren “Shtëpia e Sigurtë” është i përkohshëm, deri në 6 muaj, por në strehimore ndodh që për ndonjë rast më specifik strehimi ti vazhdohet deri në 1 vit, por varësisht nga rasti ndodh që edhe deri në dy vite. Viktimat e dhunës në familje, pas qëndrimit gjatshëmujor transferohen në strehimoret tjera (në regjionet tjera të Republikës së Kosovës), ku në çdo strehimore qëndrimi i tyre zgjat jo më

tepër se gjashtë muaj. Mandej këto viktime të dhunës, nuk kanë zgjidhje tjetër, ose të kthehen në shtëpinë e gjinisë së tyre, ku shpeshherë ndodhë që mos ti pranojnë edhe ato, ose të kthehen sërish tek kryerësi i cili ka ushtruar dhunë ndaj tyre, pasi që nuk mund të bëjnë zgjidhje tjetër.

Krahas numrit të raportuar, rastet e dhunës në familje mbeten më tepër raste të izoluara dhe shumë pak të raportuara. Nga ndryshimet e statistikave nga viti në vit, vërehet se ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në institucionet gjegjëse, që na bënë të kuptojmë se është rritur dukshëm vetëdijesimi qytetar për të raportuar dhunën krahasuar me periudhat e mëhershme, por njëkohësisht është rritur edhe besimi qytetar në institucionet që luftojnë këtë fenomen.

Viktima të dhunës në familje, marrë për bazë statistikën e vitit 2021, 2022 dhe 2023, kryesisht janë nga gjinia femërore.

Frika dhe ndërgegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe assesit të mos i diskriminojë femrat.

KAPITULLI 4:

KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA

Shtirja kohore e strategjisë

Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është paraparë si një strategji 4 vjeçare që do të zbatohet në periudhën 2024-2027.

Institucionet zbatuese dhe partnere

Komuna Istogut është institucioni kryesor zbatues i strategjisë me drejtoritë përkatëse si dhe Mekanizimin Koordinues kundër Dhunës në Familje që do të kontribuon në promovimin e ligjeve për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe atë të trashëgimisë dhe familjes, informim që ndikon në parandalimin e këtij fenomeni. Këto organe kanë për detyrë që të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, fetare, etnike, moshë e racë, t'i promovojë vlerat për të drejtat e njeriut, si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi realizimin e tyre.

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të kësaj strategjie janë:

Policia e Kosovës, Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të.

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenie njerëzore etj, si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, Spitalin, Strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

KAPITULLI 5:

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

(Plani i Veprimit të kësaj Strategjie gjendet i bashkëlidhur në Shtojcën 1)

Arritja e objektivave strategjike të kësaj Strategjie është paraparë të kryhet përmes zbërthimit të tyre në disa objektiva specifike me aktivitetet përkatëse.

Aktivitetet në Planin e Veprimit janë renditur sipas tri shtyllave bazë të përcaktuara edhe në Planin e Veprimit të Kosovës: **Parandalim, Mbrojtje dhe Riintegrim**. Për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie, aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit për zbatim:

Afat Shkurtra: aktivitete të rëndësisë së lartë që duhet të zbatohen brenda një afati kohor të shkurtër 6 muaj – 1 vit. Të tilla mund të jenë ngritja dhe forcimi institucional për adresimin e Dhunës në Familje, çështje që lidhen me forcimin e mbrojtjes etj.

Afat Mesme: aktivitete të rëndësishme që duhet zbatohen brenda periudhës kohore 1-2 vjeçare. Ndër aktivitete të tilla mund të jenë edhe ato që kërkojnë fonde, të cilat duhet të sigurohen nga institucionet gjegjëse për implementimin e kësaj strategjie.

Afat Gjata: janë renditur të gjitha aktivitetet të cilat synojnë konsolidimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të mbështetjes që u jepet të mbijetuarave prej Dhunës në Familje, shërbimeve cilësore, etj.

Aktivitete në vijimësi: janë aktivitete, të cilat do të kryhen prej institucioneve zbatuese dhe atyre partnere në vijimësi, si pjesë e punës së tyre. Ndër to mund të përmendim aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin, informimin dhe vetëdijesimin e komunitetit.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT –

A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Objektiv Specifik A.1.

Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje:

Aktivitete:

- Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Istogut
- Trajnimet për barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve komunale

Objektiv Specifik A.2.

Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe OJQ-ve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazive gjinore.

Aktivitete:

- Fushata (drama me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje , ligjërata, ese, dhe piktura me të rinjtë dhe grupe të ndryshme të interesit)
- Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Dhunën në Familje. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje
- Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth Dhunës në Familje, me përfaqësues të institucioneve dhe të OJQ-ve

Objektiv Specifik A.3.

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse

Aktivitete:

- Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Objektiv Specifik B.1:

Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Arsimit të Mesëm të Lartë për çështjet e Dhunës në Familje dhe LMDHF

Aktivitete:

- Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj
- Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit
- Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, fletëpalosje)

Objektiv Specifik B.2:

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të Edukatës Qytetare lidhur me Dhunën në Familje dhe trajtimin e saj

Aktivitete:

- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të Edukatës Qytetare për çështje të Dhunës në Familje
- Organizimi i shkëmbimit të përvojave përmes vizitave studimore të specialistëve të kësaj fushe

Objektiv Specifik B.3:

Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme të ulët dhe të lartë si rezultat i Dhunës në Familje, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme

Aktivitete:

- Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve
- Vetëdijesimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të veçanta që shfaqin probleme të Dhunës në Familje
- Aplikimi i masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës

**FUSHA E VEPRIMIT –
C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE**

Objektiv Specifik C.1:

Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim

Aktivitete:

- Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të Dhunës në Familje
- Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës
- Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirimin nga taksat komunale për rastet e dhunës në familje në rastet e hapjes së një biznesi të ri

Objektiv Specifik C.2:

Mbështetje socio-ekonomike të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes
- Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës
- Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së subvencioneve për bujqësi si dhe hapja e bizneseve të vogla
- Përkrahja e Strehimores, rritja e kapacitetit për shkak të numrit të strehuarve jo i mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje si dhe bashkëpunimi me mekanizmat që merren me çështjet e dhunës në familje

Objektiv Specifik C.3:

Zgjidhje e strehimit për rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura

FUSHA E VEPRIMIT –

D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektiv Specifik D.1:

Fuqizimi i Mekanizmit koordinues në nivel të komunës

Aktivitete:

- Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi
- Takime periodike të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje për shkëmbim informacioni dhe koordinim aktivitetesh

Objektiv Specifik D.2:

Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për Dhunën në Familje prej secilit institucion dhe planifikimin e masave parandaluese

Aktivitete:

- Identifikimi i rasteve të dhunës në familje
- Regjistrimi në data bazë dhe vlerësimi i nevojave të mbijetuarve të dhunës në familje

KAPITULLI 6

PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM

Për monitorimin dhe zbatimin e kësaj strategjie obligohet Komuna e Istogut dhe drejtoritë përkatëse në këtë dokument.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të saj si dhe ato partnere duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit - me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

Të paktën një herë në vit, Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin në zbatimin e strategjisë sipas treguesve të përcaktuar për çdo drejtim strategjik.

SHTOJCA 1:

PLANI I VEPRIMIT

Komuna Istogut

**PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE
(2024 – 2026)**

